



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria për Arsim

10 Nr. 155/18

Datë: 01.03.2018

Bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, nenin 5. Pika c, të Ligjit nr. 03/L – 068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ, Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.06/2015 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm. Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtri, shpall këtë :

KONKURS

Për vendet e lira punës

- **SHFMU ” Adem Voca”Pasomë**
1 Mësimdhënës/e për lënden gjuhë angleze me kohë të caktuar.
- **SHMU-1-Vushtri**
1 Mësimdhënës/e për lënden gjuhë angleze me kohë të caktuar.
- **SHMU-2-Vushtri**
1 Mësimdhënës/e për lënden matematikë me kohë të caktuar.
- **SHFMU”Azem Bejta”Dubovc**
1 Mësues/e klase me kohë të pacaktuar.

Kushtet për mësimdhënës :

Për këto vende të punës kërkohet kualifikimi përkatës profesional, sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të përgjithshëm.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjuhë angleze

- Fakulteti i Edukimit- programi i gjuhës dhe letërsisë angleze
- Fakulteti i Filologjisë-dega e gjuhës dhe letërsisë angleze.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Matematikë

- Fakulteti i Edukimit- programi matematikë-informatikë
- FSHMN-dega e matematikës arsimore

Kriteret e kualifikimit për Mësues/e klase

- Fakulteti i Edukimit- programi fillor.
- Fakulteti i Mësuesisë.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim :

- Formulari i aplikimit i cili merret në zyrën e arkivit Komunal
- Diploma (Certifikata e diplomimit jo më e vjetër se gjashtë muaj) e fakultetit e fotokopjuar dhe e vërtetuar nga noteri
- Fotokopja e letërnjoftimit
- Vërtetimi i përvojës së punës
- Vërtetimi nga gjykata se nuk është nën hetime
- Certifikatat e trajnimeve.

Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen. Konkursi mbetet i hapur 8 ditë prej ditës së shpalljes në shtyp, **prej datës 02.03.2018 deri me 12.03.2018**. Dokumentet e pakompletuara nuk shqyrtohen.

Intervistimi me shkrim i kandidatëve mbahet më **14.03.2018, në ora: 11:00** në sallën e Kuvendit Komunal.